



Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, pika 1.1.1, nenit 12 paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe nenit 22 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 15.06.2023, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti APK-DPKI-06-722/23, për zyrtarin e lartë z. Adrian Krasta, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Ardian Krasta, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pas informatës së pranuar nga jashtë - raportues anonim (DPKI-06/722/23), me pretendimin për konflikt të interesit lidhur me zyrtarin e lartë publik z. Adrian Krasta, Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Radiotelevizionit të Kosovës (në vijim: RTK) pasi që, siç është theksuar në raportimin e rastit:

“z. Krasta, më datë 14 janar 2023, është emëruar kundërligjshëm në pozitën e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të RTK-së (Radiotelevizioni i Kosovës) duke qenë në konflikt interesi, përkatësisht i punësuar në një medium tjetër privat. Emërimi ka ndodhur në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e përgjithshme të konkursit të cilat duhen plotësuar nga kandidati me rastin e aplikimi, përkatësisht me pikën: ‘Të mos ketë angazhime biznesi ose çfarëdo lloj çështjeje, të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi, i paraparë në bazë të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik’.

Krasta si para edhe pas emërimit në pozitën e zyrtarit të lartë publik (zëvendësdrejtor i përgjithshëm në RTK), është duke vazhduar punën në një medium konkurrent që transmetohet edhe në platformat kablore televizive në Kosovë. Ai drejton emisionin “A” në televizionin Syri TV dhe në mediet online të këtij biznesi mediatic. [...] Krasta duke qenë zyrtar i lartë publik, si menaxher i mediumit publik në Kosovë, është i punësuar me kohë të plotë, edhe në një detyrë tjetër në fushën e njëjtë të medias, veprim ky i sanksionuar me



Nenin 12 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Edhe pas zgjedhjes ne krye të menaxhmentit te RTK-se, Krasta në profilin e tij në facebook ka vazhduar po ashtu të shpërndaj emisionin e drejtuar prej tij, prodhim i mediumit privat, konkurrent të RTK-së. Ai për asnjë moment nuk e ka promovuar mediumin publik RTK-në ku ka lidhur marrëdhënie pune si menaxher. [...] Me angazhime të tilla, z. Krasta mund të dëmtojë reputacionin e institucionit, mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private, mund të ndikojë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe të cenoj respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë.”

Në raportimin e rastit të parashtruar në Agjenci, përveç pretendimeve për konflikt të interesit, raportuesi i rastit ka ngritur pretendime edhe për (kundër)ligjshmërinë dhe (pa)rregullsinë e procesit të përzgjedhjes së z. Adrian Krasta në pozitën e Zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, mandej pretendime tjera që lidhen me shkeljen e ligjeve dhe akteve nënligjore të RTK-së, për mosvijueshmërinë e rregullt në punë nga z. Adrian Krasta, si dhe pretendime tjera jashtë sferës së konfliktit të interesit, që nuk janë mandat i Agjencisë.

Mirëpo, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (në vijim: Agjencia) konform mandatit dhe kompetencave ligjore që ka sipas Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ka zhvilluar hetimin administrativ duke trajtuar dhe shqyrtuar vetëm pretendimet për konflikt të interesit, duke u bazuar në dispozitat e LPKI-së.

Kësisoj, Agjencia me shkresën zyrtare DPKI-06-02/776/23, e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Adrian Krasta lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Pas kësaj, është organizuar dhe mbajtur një takim në zyrat e Agjencisë, me ç’rast zyrtari në fjalë është njoftuar me pretendimet e raportuesit të rastit dhe me faktet që posedon Agjencia, sa i përket pretendimeve të ngritura për konflikt të interesit.

Në takimin e mbajtur dhe përmes e-mailit sqarues të dërguar në Agjenci (DPKI-06-02/776-1/23), z. Adrian Krasta ka paraqitur pozicionin dhe argumentet e tij karshi pretendimeve të ngritura. Kështu, sa i përket dyshimit për konflikt të interesit në lidhje me angazhimin e tij në një medium privat të Republikës së Shqipërisë, krahas të qenurit Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i RTK-së, i njëjti ka theksuar se për më tepër se tre vite është moderator i një emisioni në një medium privat të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ka sqaruar se këtë angazhim e ka në bazë të një kontrate dhe se nuk është as producent i emisionit e as nuk ka ndonjë funksion tjetër në atë medium apo në subjektin tregtar që ka në pronësi mediumin.

Tutje në e-mailin e tij dërguar në Agjenci, z. Adrian Krasta ka sqaruar se: “Procesi i zgjedhjes time është bërë nëpërmjet konkursit bazuar mbi rregulloret me të cilat funksionon në mënyrë të brendshme RTK si institucion publik. Procesi ka qenë i monitoruar dhe vendimet apo procesverbalet janë lehtësisht të gjeteshme në administratë. Unë mbaj dy nënshtetesi. Mundësitë dhe detyrimet në Kosovë e Shqipëri, përkatësisht, janë ligjërisht të ndara dhe të dallueshme, sic ndodhë në dy shtete të ndryshme. Në Shqipëri kam punuar ne Tv e Radio për 35 vjet, për më shumë se tre vjet punoj moderator në Syri TV. Në Kosovë [...] mbaj pozicion menaxherial prej Shkurtit 2023. [...]”

Nga kërkesa e raportuesit të rastit për iniciimin e procedurës së hetimit administrativ dhe linqet e bashkangjitura, takimi i mbajtur dhe sqarimi i dërguar nga z. Adrian Krasta, si dhe nga informatat e siguruara sipas detyrës zyrtare, Agjencia ka konstatuar se, me Vendimin nr. protokolli 0013/23, të datës 14.01.2023 të Bordit të RTK-së, z. Adrian Krasta është emëruar Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i RTK-së.

I njëjti, njëkohësisht është moderator/autor i emisionit “A Show” i cili transmetohet një herë në javë në një medium privat të Republikës së Shqipërisë. Nga informatat e siguruara, nuk figuron se zyrtari në fjalë ka ndonjë funksion tjetër përveç si moderator/autor i emisionit të sipërpërmendur.

Rrjedhimisht, nuk është gjetur që z. Adrian Krasta, krahas funksionit Zëvendësdyrëtor i Përgjithshëm i RTK-së, të ketë angazhime tjera në Republikën e Kosovës, ndërsa mediumi - subjekti në të cilin është i angazhuar zyrtari në fjalë si moderator/autor i emisionit si më lartë, nuk është i Republikës së Kosovës.


Në vështrim të pretendimeve dhe gjendjes faktike si më lartë, Agjencia konstatoi si në dispozitiv të këtij vendimi, se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, pasi që me dispozitat e LPKI-së nuk parashihet ndonjë ndalesë apo kufizim, për sa i përket zyrtarit të lartë publik, në rastin konkret Zëvendësdyrëtorit të Përgjithshëm të RTK-së, që të angazhohet njëkohësisht si moderator/autor i një emisioni në një medium të Republikës së Shqipërisë.

Dispozitat e LPKI-së nuk mëtojnë që të kufizojnë apo pengojnë ushtrimin e funksioneve publike, përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësiive ligjore dhe kushtetuese në institucione publike, por përkundrazi, njëri ndër qëllimet e rëndësishme të këtij ligji është funksionimi i institucioneve publike përmes parandalimit të shfrytëzimit të funksionit publik për interesa private, përkatësisht parandalimit të situatave të konfliktit të interesit, duke mbrojtur kështu interesin publik, ruajtur kredibilitetin dhe imazhin e institucioneve publike.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtore i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

(Stamp: Agjencia e Korrupsionit dhe Parandalimit të Korrupsionit - AKPK)